



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES

REKTORI


Prof. Dr. Agron **CUKA**



TESTET PRAKTIKE TË PRANIMIT NË
FAKULTETIN E SHKENCAVE TË LËVIZJES
MESHKUJ

DEKANI

Prof. Dr. Bardhyl **MISJA**



VITI AKADEMIK 2020 – 2021

TË NDERUAR KONKURUES

Ju urojmë mirseardhjen dhe ju falenderojmë për zgjedhjen e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes (FSHL) si një nga rrugët më të mira që ju siguron shkollimin tuaj të lartë dhe të ardhmen.

Këtë vit Konkursi për zgjedhjen tuaj për pranim si studentë për të ndjekur studimet e larta në Universitetin e Sporteve të Tiranës – Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes do të jetë me 2 Teste Praktike:

- Testi Nr. 1 i barazvlefshëm me 60 pikë maksimale.
- Testi Nr. 2 i barazvlefshëm me 10 pikë maksimale.

Në konkurimin praktik, konkuresi ka në dispozicion 70 pikë që përbëjnë 70 % të pikëve totale si dhe 30 % në vlerësimin e notës mesatare dhe treguesve të tjerë të shkollës së mesme që kërkohen nga MASR.

Kanë të drejtë të rregjistrohen për të konkuruar të gjithë kandidatët që kanë përfunduar nivelin e arsimit të mesëm të lartë dhe që plotësojnë kriterin e notën mesatare sipas VKM në fuqi.

Mbështetur në Vendimin Nr.9, datë 27.02.2018 pika 2, të Senatit të UST-së: “Kandidati konkures, duhet të marrë së paku 10 pikë në testimin e konkursit praktik. Nëse merr më pak se 10 pikë, kandidati nuk shpallet fitues dhe nuk rregjistrohet për të ndjekur studimet”

Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim

- Fotokopje e Kartës së Identitetit ose Pasaportës.
- Kartela Mjekësore që vërteton gjendjen shëndetësore të konkuresit në përballimin e sforcimeve fizike, i plotësuar nga mjekët specialist të rretheve përkatëse.
- Mandat pagesën për konkurim.
- 2 foto të vlefshme për dokumenta.

TESTI Nr. 1 (Meshkuj)

Përmbajtja e Testit

Është i përbërë nga 7 (shtatë) stacione:

1. Vrapim 2 x 10 m, me 2 vajtje ardhje me rrotullim pas koneve (piramida, flamur etj) përkatëse.
2. Vrapim sllallom ndërmjet 6 koneve (piramida, flamur etj) të vendosura 2.5 m larg njëra – tjetrës dhe rrotullim pas konit përballë (8.5 m larg konit të fundit).
3. Kapërcim mbi piketa, me ngritje gjunjësh në formë “skip” 6 piketa në distancë 80 cm larg njëra – tjetrës.
4. Kërcim i 5 pengesave skip (me të dyja këmbët) të vendosura në formë zik – zak (lartësia e pengesave për meshkuj është 70 cm).
5. Vrapim 2 x 10 m, me rrotullim pas konit përkatës.
6. Rrotullim pas konit përkatës, vrull, kapërdimje para.
7. Kalim i lirë me të dyja këmbët sipër i 5 pengesave (të atletikës) të vendosura 3 m larg njëra–tjetrës (lartësija 70 cm).

Mos ekzekutimi i një elementi të testit çon në penalizimin e kandidatit.

Mjetet që do të përdorim

Kone plasike, (piramida, flamurë) piketa plastike, pengesa të atletikës, dyshekë sfungjeri (në sallë), metër shirit (25 m ose 50 m), metër druri ose metalik (me gjatësi 2 m), kronometra elektronikë, nastër ngjitëse për vijëzime.

Ekzekutimi i Testit Nr. 1 (Meshkuj)

Kandidati nis në vendin ku shënohet “Nisja”. Në momentin që kandidati nis, shtypet kronometri për matjen e kohës së testit. Konkuruesi vrapon nga nisja 10 m dhe rrotullohet rreth konit të parë duke u kthyer përsëri në vendin e nisjes. Këtë vrapim (2 x 10 m) e përsërit 2 herë. Më pas vrapon drejt dhe kalon nëpërmjet koneve në formë sllallomi, më pas rrotullohet pas konit të vendosur 8.50 m përballë dhe kapërcen 6 piketa të vendosura 80 cm larg njëra-tjetrës me gjunjët lart në formë “skip”. Më pas kërcëjmë pupthi 5 pengesa (atletike, lartësija 70 cm) të vendosura në formë zik-zak. Sapo dalim te kthesa e fundit vrapojmë me kthim djathtas duke u rrotulluar pas piketës që ndodhet përballë në distancë 4 m, vrapojmë 10 m duke u rrotulluar pas piketës së rradhës dhe vrapim 10 m të tjera në kthim ku rrotullohet pas konit përkatës dhe pas një vrapimi të shkurtër bëhet një kapërdimje para dhe menjëherë pas ngritjes kapërcëjmë 5 pengesa (atletike, lartësija 70 cm) të vendosura 3m larg njëra-tjetrës në formë të lirë dhe nga pengesa e fundit distanca e mbetur kryhet me vrapim të shpejtë. Në momentin që konkuruesi kalon vijën ku shënohet “Mbriritja” shtypet kronometri dhe përcaktohet koha e testit e cila korespondon me pikët përkatëse të përcaktuara në tabelë.

Bashkëlidhur keni skicën përkatëse të Testit Nr. 1 – Meshkuj.

Ndëshkimet (penalitetet)

1. Në stacionin e parë. Vrapimi 4 x 10 m është detyrues.
Në rast se kandidati kryen vetëm 2 x 10 m në përfundim të testit në formularin përkatës atij i shënohet nuk përfundon garën.
2. Në stacionin e dytë është detyruese të kalohen të 6 konet. Rrëzimi i cdo koni ndërshkohet me minus 1(një) pikë. Rrotullimi mbas konit përballë për të kaluar te kërcimi i piketave është detyrues.
Në rast të kundërt për arsye të shkurtimit të distancës, konkruesi ndëshkohet me **minus 5 (pesë) pikë**.
3. Në stacionin e tretë kapërcimi i 6 piketave me gjunjët lart në formë “skip” është detyrues.
Në rast të kundërt konkruesi ndëshkohet me **minus 5 (pesë) pikë**.
4. Në stacionin e katërt kërcimi i 5 pengesave të vendosura zik-zak është detyrues me të dyja këmbët siper pengeses .
Në rast mos kapërcimi për çdo pengesë, konkruesi ndëshkohet me minus 5 (pesë) pikë. (Në rast se nuk kapërcen asnjërën nga pengesat, konkruesi ndëshkohet me **minus 25 (njëzetë e pesë) pikë**).
5. Në stacionin e pestë pas kalimit të pengesave rrotullohem i pas një koni të vendosur në distancë 4 m nga pengesat. Më pas kandidati kryen vrapimin 10 m në vajtje dhe 10 m në kthim sipas skicës përkatëse.
Në rast se kandidati nuk e kryen këtë vrapim në përfundim të testit në formularin përkatës atij i shënohet nuk përfundon garën.
6. Stacioni i gjashtë. Rrotullimi pas konit, para kapërdimjes mbi dyshek është detyrues. Në të kundërt për shkurtim distance ose për mos kryerjen e kapërdimjes para, konkruesi ndëshkohet me **minus 5 (pesë) pikë**.
7. Kapërcimi i 5 pengesave të (atletikës) është detyrues me të dyja këmbët sipër pengesës. Rrëzimi i pengesës pas kapërcimit të saj nuk përbën shkelje dhe nuk penalizohet. Për çdo pengesë që nuk kapërcehet konkruesi ndëshkohet me minus 5 (pesë) pikë. Mos kapërcimi i 5 pengesave ndëshkohet me **minus 25 (njëzetë e pesë) pikë**.
Nuk lejohet vrapimi i drejtë duke shmangur të gjitha pengesat. Për një rast të tillë duke përfutuar në kohë në mënyrë të parregullt kandidatit i shënohet në formularin përkatës “**nuk përfundon testin**”.

Kandidati duhet të përshkojë distancën e plotë të testit dhe në përfundim duhet të vlerësohet me pikët përkatëse sipas tabelës bashkëlidhur testit praktik.

Kandidati i cili shkurton distancën e testit për të përfutuar në kohë nuk vlerësohet nga komisioni dhe në formularin përkatës shënohet “Nuk përfundon testin”, dhe vlerësohet me 0 (zero) pikë.


Kronometrimi i kohës së testit do të realizohet në mënyrë elektronike me fotofinish.

Në rast se për arsye të paparashikuara fotofinishi mund të mos jetë funksional koha e testit do të matet me kronometër dore, ku detyrimisht do të jenë 3 (tre) anëtarë me nga një kronometër dhe kandidatit i shënohet mesatarja e kohës së kronometruar.

Në rast se gjatë konkurimit kërkohet ndonjë zgjidhje e paparashikuar në këtë rregullore apo për ndonjë arsye tjetër të çfarë do lloji qoftë ajo, komisioni ka të drejtën e vendimmarrjes.

Kjo vendimmarrje do të pasqyrohet në një proces - verbal të veçantë në momentin e vendimit duke shpjeguar argumentet përkatëse.

TESTI PRAKTIK Nr.1 PER KONKURSION E PRAMIMIT - MESHKUT NE U.S.T. - FAKULTETI I SHKENCAVE TE LEVIZJES




NISJA

MBRRITJA

30 m

19 m

TESTI PRAKTIK Nr.1 PER KONKURSION E PRAMIMIT - MESHKULT
 NE U.SIT. - FAKULTETI I SHKENCAVE TE LEVIJTES - VITI 2020



NISJA

MBRITJA

30 m

19 m

TESTI PRAKTIK Nr. 1 (MESHKUJ)
PËR KONKURSION E PRANIMIT NË UST
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES
PËR VITIN 2020 – 2021

KOHA	PIKËT	KOHA	PIKËT
37.00"	60.00	40.00"	45.00
37.10"	59.50	40.10"	44.50
37.20"	59.00	40.20"	44.00
37.30"	58.50	40.30"	43.50
37.40"	58.00	40.40"	43.00
37.50"	57.50	40.50"	42.50
37.60"	57.00	40.60"	42.00
37.70"	56.50	40.70"	41.50
37.80"	56.00	40.80"	41.00
37.90"	55.50	40.90"	40.50
38.00"	55.00	41.00"	40.00
38.10"	54.50	41.10"	39.50
38.20"	54.00	41.20"	39.00
38.30"	53.50	41.30"	38.50
38.40"	53.00	41.40"	38.00
38.50"	52.50	41.50"	37.50
38.60"	52.00	41.60"	37.00
38.70"	51.50	41.70"	36.50
38.80"	51.00	41.80"	36.00
38.90"	50.50	41.90"	35.50
39.00"	50.00	42.00"	35.00
39.10"	49.50	42.10"	34.50
39.20"	49.00	42.20"	34.00
39.30"	48.50	42.30"	33.50
39.40"	48.00	42.40"	33.00
39.50"	47.50	42.50"	32.50
39.60"	47.00	42.60"	32.00
39.70"	46.50	42.70"	31.50
39.80"	46.00	42.80"	31.00
39.90"	45.50	42.90"	30.50

KOHA	PIKËT	KOHA	PIKËT
43.00"	30.00	46.00"	15.00
43.10"	29.50	46.10"	14.50
43.20"	29.00	46.20"	14.00
43.30"	28.50	46.30"	13.50
43.40"	28.00	46.40"	13.00
43.50"	27.50	46.50"	12.50
43.60"	27.00	46.60"	12.00
43.70"	26.50	46.70"	11.50
43.80"	26.00	46.80"	11.00
43.90"	25.50	46.90"	10.50
44.00"	25.00	47.00"	10.00
44.10"	24.50	47.10"	9.50
44.20"	24.00	47.20"	9.00
44.30"	23.50	47.30"	8.50
44.40"	23.00	47.40"	8.00
44.50"	22.50	47.50"	7.50
44.60"	22.00	47.60"	7.00
44.70"	21.50	47.70"	6.50
44.80"	21.00	47.80"	6.00
44.90"	20.50	47.90"	5.50
45.00"	20.00	48.00"	5.00
45.10"	19.50	48.10"	4.50
45.20"	19.00	48.20"	4.00
45.30"	18.50	48.30"	3.50
45.40"	18.00	48.40"	3.00
45.50"	17.50	48.50"	2.50
45.60"	17.00	48.60"	2.00
45.70"	16.50	48.70"	1.50
45.80"	16.00	48.80"	1.00
45.90"	15.50	48.90"	0.50
		49.00"	0.00

TESTI Nr. 2

KËRCIM SË GJATI NGA VENDI MESHKUJ – FEMRA 2020–2021

Përmbajtja dhe Ekzekutimi i Testit.

Ky test kryhet brënda një kuadrati me gjatësi 4 m dhe gjerësi 3m. Përmasat e këtij kuadrati nuk janë detyruese por e rëndësishme është që vendi i kryerjes së testit të krijojë mundësi optimale për arritjen e rezultatit maksimal nga konkuruksi.

Në kryerjen e këtij testi konkuruksi vendos këmbët mbi vijën përkatëse të nisjes (kërcimit). Në mënyre të lirë ai kërcen me të dyja këmbët nga vendi duke synuar një distancë sa më të largët. Vendosja e këmbëve bëhet pa e kaluar vijën kufizuese dhe matja e distancës kryhet nga vendi i kërcimit deri në pikën më të afërt nga kjo vijë që shkel konkuruksi, sipas skicës përkatëse.

Çdo konkuruks ka të drejtën e dy provave rradhazi dhe në vlerësimin përfundimtar i shënohet rezultati më i mirë nga dy provat.

Testi është i njëjtë për meshkuj dhe femra, por vlerësimi me pikë ndryshon sipas tabelës përkatëse të pikëzimit, (Meshkuj – Femra).

TESTI N° 2. MESHKUD
KERCIM SE QJATI NGA VENDI




TABELA E VLERËSIMIT PËR TESTIN – NR. 2
 KËRCIM SË GJATI NGA VENDI
 PËR KONKURSIN E PRANIMIT NË UST
 FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES
 (MESHKUJ - FEMRA) PËR VITIN 2020 – 2021

Pikë	Kërcim së gjati nga vendi	
	Meshkuj	Femra
10.00	280 cm	240 cm
9.50	275	235
9.00	270	230
8.50	265	225
8.00	260	220
7.50	255	215
7.00	250	210
6.50	245	205
6.00	240	200
5.50	235	195
5.00	230	190
4.50	225	185
4.00	220	180
3.50	215	175
3.00	210	170
2.50	205	165
2.00	200	160
1.50	195	155
1.00	190	150
0.50	185	145
0.00	180	140